



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 98/2 Prot.

Tiranë, më 13.01.2026

**VENDIM**

Nr. 4 Datë 13-01 2026

**“PËR  
NISJEN E PROCEDURAVE PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT  
"MASTER I SHKENCAVE" NË 'REHABILITIM TË PROFESIONEVE TË  
SHËNDETIT", ME DIPLOMË TË DYFISHTË, MIDIS UNIVERSITETIT TË  
SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT  
DHE UNIVERSITETIT TË KATANXAROS "MAGNA GRECIA" NË ITALI DHE  
MIRATIMIN E MARRËVESHJE PËR PROGRAMIN”**

Mbështetur në nenin 3, 49 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës", Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, në nenin 7, 43, 73 të Statutit të UST-së, në Rregulloren e UST-së, shkresën nr. 76/2 prot., datë 12.01.2026 prot., datë 07.01.2026 të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit "Nisja e procedurave për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në "Rehabilitim të Profesioneve të Shëndetit", me diplomë të dyfishtë në bashkëpunim me Universitetin e Katanxaros "Magna Grecia" në Itali, pranë Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 8 datë 13.01.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 13.01.2026,

**VENDOSI:**

01. Miratimin e nisjes së procedurave për hapjen e programit të përbashkët "Master i shkencave" në "Rehabilitim të profesioneve të shëndetit", me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit dhe Universitetit të Katanxaros "Magna Grecia", në Itali.

02. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për programin e përbashkët me Universitetin e Katanxaros "Magna Grecia", në Itali (bashkëlidhur vendimit).
03. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al).

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**Artur ÇOBANI**

**NË MUNGESË DHE ME POROSI**

**Prof. Asc. Dr. Marsela SHEHU**

